



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Zyra për Komunikim Publik/ Ured za Javno Komuniciranje/ Public Communication Office

RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS
I INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR REALIZIMIN E SË DREJTËS PËR QASJE
NË DOKUMENTE PUBLIKE

Raporti vjetor 2014

Prishtinë, mars 2015

Përmbajtja

	Faqe
1. Përmbledhje	4
2. E drejta e qasjes në dokumente publike	
2.1 Parimet themelore	6
2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike	6
2.3 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë	8
2.3.1 Aktet juridike	8
3. Aktivitetet në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike	
3.1 Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe sfidat në procesin e punës	10
3.2 Konferenca Rajonale	10
3.3 Marrëveshjet për shkëmbim të praktikave të mira	11
3.4 Trajnimet	11
3.4 Raportet lidhur me lirinë e informimit	12
4. Kërkesat për qasje në dokumente publike	
4.1 Institucionet e mbuluara me Ligjin Nr. 03/ L-215 për Qasje në Dokumente Publike	14
4.2 Të dhënat e përgjithshme	15
4.2.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës	15
4.2.2 Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës	16
4.2.3 Dërgimi i raporteve të institucioneve të Republikës së Kosovës	17
4.3 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese	
4.3.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese	19
4.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara.....	19
-Realizimi i qasjes në dokumente publike	19
- Arsyet kryesore të refuzimeve dhe qasjes së kufizuar	20
- Dokumentet e kërkuara në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës	20
-Profili i aplikuesve	21
-Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa nga institucionet qendrore	22
-Mënyra e dhënies së përgjigjes në kërkesa për qasje në dokumente publike	22
4.4 Qeveria e Republikës së Kosovës	
4.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në institucionet vartëse	23
4.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Kosovës dhe në institucionet vartëse	26
- Realizimi i qasjes në dokumente publike	27
- Arsyet kryesore të refuzimeve dhe qasjes së kufizuar	27
- Dokumentet e kërkuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet vartëse	28
- Profili i aplikuesve	29
- Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet vartëse	30
- Mënyra e dhënies së përgjigjes në kërkesa për qasje në dokumente publike	30

4.5	Universitetet publike	
4.5.1	Numri i kërkesave të parashtruara në Universitetet publike.....	32
4.5.2	Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitetet publike	32
-	Realizimi i qasjes në dokumente publike	32
-	Arsyet kryesore të refuzimeve dhe qasjes së kufizuar	33
-	Dokumentet e kërkuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet vartëse	34
-	Profili i aplikuesve	34
-	Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet vartëse	35
-	Mënyra e dhënies së përgjigjes në kërkesa për qasje në dokumente publike	35
4.6	Institucionet e Pavarura	
4.6.1	Numri i kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	36
4.6.2	Analizë e kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	37
-	Realizimi i qasjes në dokumente publike të Institucioneve të Pavarura	37
-	Arsyet e refuzimeve në institucionet e pavarura	38
-	Mënyra e dhënies së përgjigjes në kërkesa për qasje në dokumente publike	38
-	Dokumentet e kërkuara në Institucione të Pavarura	39
-	Profili i aplikuesve	40
-	Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa	40
4.7	Ndërmarrjet Publike	
4.7.1	Numri i kërkesave të parashtruara në ndërmarrje publike	41
4.8	Komunat e Republikës së Kosovës	
4.8.1	Numri i kërkesave të parashtruara në Komunat e Republikës së Kosovës	43
4.8.2	Analizë e kërkesave të parashtruara në Komunat e Republikës së Kosovës	44
-	Realizimi i qasjes në dokumente publike	44
-	Dokumentat e kërkuara në komuna	44
-	Profili i aplikuesve	45
-	Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa	45
-	Mënyra e dhënies së përgjigjes në kërkesa për qasje në dokumente publike	46
4.9	Institucionet që nuk kanë dërguar raporte.....	47
5.	Rekomandime	48
6.	Shtojcat.....	49
6.1	Udhëzues mbi Ligjin për Qasje në dokumente publike.....	49
6.2	Formulari i kërkesës për qasje në dokumente publike	52
6.3	Lista e kontakteve	
6.3.1	Institucionet qendrore	53
6.3.2	Qeveria, Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë	53
6.3.3	Agjencitë vartëse të Qeverisë	54
6.3.4	Institucionet e pavarura	56
6.3.5	Ndërmarrjet publike	57
6.3.6	Komunat	58

HARTUES I RAPORTIT:**ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT**

Albulena Sylaj-Zeqiri, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun dhe Trajtimin e Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike

Arben Musliu, Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun

1. PËRMBLEDHJE

Në praktikën e shoqërive demokratike, çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe kjo përfshinë edhe të drejtën për të kërkuar dhe për të marrë informata. E drejta e qasjes në dokumente është thelbësore në arritjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera, në sigurimin e demokracisë, si dhe në zhvillimin e vendit.

Qeveria dhe organizatat tjera publike mbajnë informata të rëndësishme. Këto dokumente i mbajnë në emër të publikut, andaj edhe duhet që proaktivisht të publikojnë informata, si dhe t'u japin qasje njerëzve që duan ndonjë informatë specifike.

Ligjet për qasje në dokumente publike janë vitale për informimin e drejtë të publikut lidhur me veprimet e të zgjedhurve të tyre.

Zbatimi me sukses i këtyre ligjeve fuqizon edhe më tej rolin e komunikimit qeveritar dhe institucional me publikun dhe në të njëjtën kohë forcon transparencën dhe riafirmon vlerat kulmore të qeverisjes së mirë efektive dhe të sundimit të rendit dhe të ligjit.

Promovimi i të drejtës për qasje në dokumente publike, dërgimi i raporteve nga ana e institucioneve publike të Kosovës dhe përpilimi i Raportit Gjithëpërfshirës parashihen me nenet 20.4, 20.5 dhe 20.6 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) të cilat nene poashtu i referohen "njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit".

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së (ZKP/ZKP), që nga vitit 2011 ka emëruar Zyrtaren e Lartë për Trajtimin e Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, por për shkak të kufizimeve financiare nuk ka arritur të themelojë ndonjë njësi përkatëse ashtu siç theksohet në nenet e lartcekura.

Kjo Zyrë mbetet bartëse e zbatimit të këtij ligji, duke realizuar procedimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, duke koordinuar aktivitetet ndërmjet zyrave të institucioneve të tjera në këtë aspekt si dhe përmes trajnimit të zyrtarëve.

Që nga fillimi i implementimit të LQDP-së, zyrtarët që janë caktuar në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike janë duke u profesionalizuar në zbatimin e dispozitave që dalin nga ky ligj. Megjithëse, për shkak të ndërrimeve të vendeve të punës ka pasur raste edhe të ndërrimit të zyrtarëve të QDP-së, meqenëse ka kaluar një kohë e gjatë nga trajnimet e para dhe në ndërkohë ka pasur lëvizje të personelit edhe në institucione të nivelit qendror dhe institucione të pavarura.

Duke e parë se avancimi efektiv mund të bëhet vetëm në një bashkëpunim të gjerë me vendet e tjera të rajonit, Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit ka nisur në vitin 2014 hapjen e rrugës për bashkëpunime më të mëdha në rajon. Më 17 shtator 2014, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Zyra për Komunikim Publik në ZKM organizoi Konferencën Regjionale në Prishtinë, të titulluar "Liria e Informimit - zhvillimi i praktikave në rajonin e Ballkanit Perëndimor", duke sjellë në kryeqytetin e Kosovës komisionerë të informimit dhe njerëz të tjerë me ndikim në këtë fushë.

Kjo ishte një mundësi e mirë për të krahasuar jo vetëm normativën ligjore, por edhe për të shkëmbyer praktikat më të mira të këtij regjioni, dhe për të theksuar strategjitë e përbashkëta për të forcuar lirinë e informimit. Krijimi i një rrjetëzimi për të shkëmbyer përvojat, ishte njëra ndër kërkesat kryesore të profesionistëve të kësaj fushe, që ishin të pranishëm në Konferencë.

Duke e parë të rëndësishme arritjen e hapit me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit poashtu vitin e kaluar ka nisur procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Koncept dokumenti për ndryshimin e këtij Ligji është në programin e koncept dokumenteve të vitit 2015.

2 E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.1 Parimet themelore

Transparenca maksimale mbetet parimi themelor i legjislacionit për qasje në dokumente publike, sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë, se të gjitha informacionet që mbahen nga institucionet, duhet të jenë publike, dhe duhet të jenë të qasshme për të gjithë, dhe kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm atëherë kur ndonjë informacion bën pjesë në grupin e informatave të përjashtuara me Ligj.

Përjashtimet duhet të jenë të qarta dhe të shpjeguara mirë.

Poashtu, institucionet publike janë të obliguara që të publikojnë në faqet e tyre zyrtare në internet informacionet kryesore, dhe aktivisht të promovojnë qeverisjen e hapur.

Përveç kësaj, kërkesat për qasje në dokumente publike duhet të jenë pa pagesë, të procedohen shpejt dhe paanshëm, dhe duhet të sigurohet një rishikim i refuzimeve nga një shkallë e dytë.

Njëri nga parimet kryesore mbetet edhe obligimi që mbledhjet e institucioneve të jenë të hapura për publikun. Të gjithë individët që publikojnë informacione për veprimet e dëmshme të institucioneve ku punojnë, duhet të mbrohen.

Në Kosovë, Ligji për Qasje në Dokumente Publike bazohet në dhjetë parimet mbi të drejtën për qasje në informata:¹

1. Qasja në informata është e drejtë e secilit;
2. Qasja është rregull- sekreti është përjashtim;
3. E drejta aplikohet tek të gjitha organet publike;
4. Bërja e kërkesës duhet të jetë e thjeshtë, e shpejtë dhe e lirë;
5. Zyrtarët kanë për detyrë t'u ndihmojnë kërkuarve të informatave ;
6. Refuzimi duhet të arsyetohet;
7. Interesi publik është më i rëndësishëm se sekreti;
8. Secili ka të drejtë të ankohet ndaj vendimit të pafavorshëm;
9. Organet publike duhet në mënyrë proaktive të publikojnë informatat thelbësore;
10. E drejta duhet të garantohet nga një organ i pavarur.

2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike

Qasja në dokumente publike është e mbrojtur me konventa të shumta të të drejtave të njeriut. Më e rëndësishmja prej tyre konsiderohet Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 217 A (III), 10 dhjetor 1948.

Neni 19 i kësaj Deklarate thotë:

¹ PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR TË DREJTËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE, Përgatitur nga: BESIM M. KAJTAZI
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/I_PERMBLEDHJE_LEGJISLACIONI_PER_TE_DREJTEN_E_QASJES_NE_DOKU.pdf

Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes së mendimit; kjo e drejtë përfshin lirinë për të shprehur pikëpamjet e tij pa ndërhyrje dhe të kërkoj, marrë dhe jap informata dhe ide nëpërmes çfarëdo medie dhe pa marrë parasysh kufijtë.

Këto instrumente ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi në rast konflikti ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Më poshtë janë të radhitura instrumentet kryesore ndërkombëtare që e sigurojnë këtë të drejtë.²

Kombet e Bashkuara

- Konventa Aarhus (Konventa për qasje në informim, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në çështjet e drejtësisë në mjedis) Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara, 25 qershor 1998
- Konventa kundër korrupsionit, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 58/4 të datës 31 tetor 2003.
- Komenti i përgjithshëm numër 34, Komiteti për të drejta njerëzore i Kombeve të Bashkuara, 12 shtator 2011, që përbën një interpretim autoritativ të lirisë së shprehjes, e garantuar nga Neni 19 e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, e cila është e detyrueshme në më shumë se 165 shtete.
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200 A (XXI), 16 dhjetor 1966 (neni 19) dhe Protokollin e Parë Opsional

Këshilli i Evropës

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Fundamentale, Këshilli i Evropës, 4 nëntor 1950 (Neni 10)
- Konventa për Qasje në Dokumente Zyrtare, 27 nëntor 2008, dhe Raporti Shpjegues.
- Deklarata e Lirisë së Shprehjes dhe Informimit, Komiteti i Ministrave, sesioni i 70-të, 29 prill 1982.
- Rekomandimet CM/Rec(2008) 6 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me Masat për promovimin dhe Respektimin e Lirisë së Shprehjes dhe Informimit që lidhen me filtrat e internetit, 26 mars 2008.
- Rekomandimet Rec (2002) 2 të Komitetit të Ministrave për Qasjen në Dokumente Zyrtare, 21 shkurt 2002.
- Rekomandimet No. R (81) 19 të Komitetit të Ministrave për Qasjen në Informatat e mbajtura nga Autoritetet Publike, 25 nëntor 1981.

² <http://www.right2info.org/international-standards>

Unioni Evropian

- Kapitulli i të Drejtave Themelore të Unionit Evropian OJ C 364, 18 dhjetor 2000 (Neni 42). Garanton të drejtën e qasjes në dokumente të mbajtura nga institucionet e Unionit Evropian për "secilin qytetar të Unionit, dhe secilit person fizik ose juridik që banon ose ka zyrë të regjistruar në Shtetet Anëtare".
- Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për Qasjen e Publikut në Informatat e Mjedisit, OJ 2003 L 41/26, 28 janar 2003.
- Rregullorja (EC) No 1049/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me Qasjen e Publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit, OJ 2001 L 145, 30 maj 2001.
- Traktati i Unionit Evropian dhe Deklarata për të Drejtën e Qasjes në Informacion, OJ C 191, 29 korrik 1992.
- Traktati i Lisbonës, 2007/C 306/01, Lisbonë, 13 dhjetor 2007 zgjeron përmbledhjen e institucioneve në Rregulloren e Komisionit Evropian, e cila duhet të aplikohet nga të gjitha institucionet e Unionit Evropian dhe ndaj të gjithë aplikuesve.
- Direktiva 2013/37/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 qershor 2013, që amendamenton Direktivën 2003/98/EC për ripërdorimin e informatave të sektorit publik.

2.3 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë

E drejta për qasje në dokumente të institucioneve publike të Kosovës hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Secili individ e gëzon të drejtën për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike në nenin 41. Në frymën e këtij neni, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike më 7 tetor, 2010.

2.3.1 Aktet juridike

Qasja në dokumente publike në Republikën e Kosovës rregullohet me këto akte juridike:

- **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton:

"1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike."

"2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë."

- Ligji Nr.03/ L-215 për Qasje në Dokumente Publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.

Në funksion të zbatimit me sukses të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar:

- ▶ Rregullorja nr. 03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun;
- ▶ Rregullorja nr. 1/2012 për Kodin e Etikës për zyrtarët e komunikimit me Publikun;
- ▶ Rregullorja nr. 04/2012 për evidencën zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe pakoja e dokumenteve standarde për kërkesat për QDP;
- ▶ Rregullore nr. 02/2012/MF për tarifatat në qasje në dokumente publike;
- ▶ Udhëzimi Administrativ nr. 03/2011 për UEB-faqet e Institucioneve Publike;
- ▶ Udhëzimi Administrativ nr. 02/2011, për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës.
- ▶ Udhëzim Administrativ nr. 2008/09 për transparencën në komuna

- Ligjet tjera të ndërlidhura

- Ligji nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale
- Ligji nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë
- Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit
- Ligji nr. 02/L-28 për procedurën administrative
- Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative
- Ligji nr. 04/L-184 për administrimin e punës në Zyrë

3. AKTIVITETET NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

3.1 ZBATIMI I LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE SFIDAT NË PROCESIN E PUNËS

Katër vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit, me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka nisur vlerësimin e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Me këtë rast, janë organizuar punëtori të shumta me të gjithë akterët e përfshirë, nga institucionet qendrore, lokale, shoqëria civile dhe mediat, për të diskutuar lidhur me gjetjet e Raporteve gjithëpërfshirëse, problemet dhe sfidat në implementimin e Ligjit, por edhe për të parë mundësinë e rishikimit të vetë Ligjit.

Për të pasur një pasqyrë më të mirë se si kjo fushë është e rregulluar në vendet e rajonit, por edhe për të nisur bashkëpunimin në të mirë të shkëmbimit të përvojave me profesionistët e kësaj fushe, Zyra për Komunikim Publik, poashtu me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka organizuar më 18 shtator 2014 në Prishtinë, Konferencën Rajonale "LIRIA E INFORMIMIT PUBLIK – Zhvillimi i Praktikave në rajonin e Ballkanit Perëndimor".

Pjesëmarrësit e kësaj konference ishin përfaqësues të institucioneve që merren me lirinë e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga Sllovenia, Kroacia, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnje dhe Hercegovina, si dhe organizatat të shoqërisë civile.

Gjatë vitit, Zyra për Komunikim Publik në ZKM ka vazhduar të mbledh raportet tre mujore nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky është Raporti i katërt gjithëpërfshirës, në të cilin rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përditësimit të kontakteve tek institucionet, meqenëse ka pasur lëvizje të vazhdueshme të zyrtarëve.

Lidhur me gjendjen e lirisë së informacionit në Kosovë është shkruar në disa nga raportet më të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare të kësaj lëmie.

3.2 KONFERENCA RAJONALE

Në organizim të Zyrës për Komunikim me Publikun të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, më 18 shtator 2014 në Prishtinë është mbajtur **Konferenca Rajonale: Liria e Informimit – zhvillimi i praktikave në rajonin e Ballkanit Perëndimor.**

Hapjen e konferencës e bëri zëvendëskryeministrja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Edita Tahiri, si dhe Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Jean-Claude Schlumberger.

Përfaqësues të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë, prezantuan përvojat e vendeve të tyre në kuadër të temave të 3 paneleve të konferencës:

- Vështrim i përgjithshëm i situatës aktuale në rajon: organizimi institucional, legjislacioni dhe zbatimi i kuadrit ligjor;
- Llogaridhënia dhe monitorimi i qeverisë në përputhje me legjislacionin për lirinë e informimit,
- Të dhënat personale dhe mbrojtja e privatësisë.

Ndërkaq, konkluzionet e kësaj Konference, ishin:

1. Nevoja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave është e domosdoshme dhe në funksion të avancimit të realizimit të së drejtës së lirisë së informimit;
2. Duke ditur që e drejta e informimit publik është e drejtë themelore e njeriut, angazhohemi për realizimin e plotë të saj;
3. Është e domosdoshme nisja e zbatimit të Direktivës së Komisionit Evropian nr.2013/37/EU për ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik;
4. Praktikrat e vendeve të rajonit dëshmojnë se organi që mbikëqyrë zbatimin e ligjeve të lirisë së informimit publik duhet të jetë i pavarur dhe me fuqi ekzekutive;
5. Bashkëpunimi në fushën e lirisë së informimit publik do të vazhdojë në mënyrë intensive edhe në të ardhmen;
6. Pajtohemi për krijimin e një forumi të veçantë të përfaqësuesve që merren me lirinë e informimit publik në vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe avancimin e realizimit të së drejtës për qasje në informacione me karakter publik;
7. Të shikohen mundësitë që konferenca rajonale mbi lirinë e informimit publik, të jetë vjetore;

3.3 MARRËVESHJET PËR SHKËMBIM TË PRAKTIKAVE TË MIRA

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik i Republikës së Maqedonisë kanë nënshkruar më 4 prill 2014 Memorandumin e bashkëpunimit në lëmin e mbrojtjes të së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Përpos përforsimit të komunikimit biletaral institucional, ky Memorandum do të mundësojë edhe mbajtjen e trajnimeve me qëllim të këmbimit të përvojave nga të dy shtetet.

Pra, megjithëse hapi i parë është bërë, ende ka nevojë që të punohet më shumë në bashkëpunimet rajonale. ZKP/ZKM në bashkëpunim me përfaqësuesit e Maqedonisë do të hartojnë plane të përbashkëta për shkëmbime.

ZKP/ZKM do të analizojë përfitimet nga bashkëpunimi me institucione respektive të vendeve të ndryshme dhe mandej do të vendosë edhe për marrëveshje bashkëpunimi edhe me vende tjera. Një praktikë e tillë do të mundësojë edhe shkëmbimin e informatave kontaktuese, dhe krijimin e një rrjeti të zyrtarëve përgjegjës për monitorimin e zbatimit të LQDP-së.

3.4 TRAJNIMET

Më 17 shtator, Zyra për Komunikim Publik (ZKP) e Zyrës së Kryeministrit zhvilloi një takim konsultativ me dy këshilltarë ligjorë të Komisionerit Sloven të Informacionit (KSI), znj. Jasna Duralija dhe znj. Maja Lubarda. Këshilltarët ligjorë nga KSI shqyrtuan Ligjin për QDP dhe kornizën e miratimit të qasjes. Të gjithë pjesëmarrësit arritën në përfundimin e përbashkët se Ligji aktual për Qasje në Dokumente Publike ka mangësi të mëdha dhe duhet të ndryshohet.

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit, me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka mbajtur punëtorinë “Sfidat në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, katër vite pas hyrjes në fuqi”, me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve, shoqërisë civile dhe gazetarët.

- Punëtorja e parë është e mbajtur më 10 tetor 2014 në Prishtinë, me përfaqësuesit e institucioneve qendrore, ministritë, si dhe agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës.
- Më 30 tetor 2014 në Prizren, është mbajtur punëtorja me përfaqësuesit e komunave të Kosovës.
- Më 7 nëntor 2014, është mbajtur tryezë me përfaqësuesit e medieve dhe të shoqërisë civile.

3.4 RAPORTET LIDHR ME LIRINË E INFORMIMIT

Gjatë vitit 2014 ka pasur një numër të Raporteve për Kosovën, të cilat kanë mbuluar edhe realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Raporti i Progresit për Kosovën, i Komisionit Evropian, përmend zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, kur flet për administratën publike.³

- o Progres shumë i limituar është bërë për të përmirësuar llogaridhënien dhe shërbimet publike. Ligjet për procedurën administrative dhe aktet nënligjore ende nuk janë kompletuar. Zbatimi i Ligjit për qasje në dokumente publike mbetet i pakënaqshëm. Kosova poashtu ka nevojë të rishikoj organizimin e administratës publike në nivelin lokal, sidomos në dërgimin e kompetencave dhe në emërimin e drejtorëve.

Po i njëjti Raport përmend edhe sfidat tek qeverisja lokale:

- o Përpjekjet e komunave për të rritur transparencën në vendimmarrje duhet të vazhdojnë. Udhëzimi i ri administrativ për transparencën në komuna është zbatuar në vetëm dy komuna.⁴

Sfidat në zbatimin e Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike janë përmendur edhe në Raportin e SIGMAS, “Vlerësimi i Reformës së Administratës Publike të Kosovës”.⁵

Paqartësia se kush vendos për refuzim, si dhe mungesa e një autoritet qendror mbikëqyrës, me fuqi ekzekutive, sipas këtij raporti, mbeten problemet kryesor, derisa theksohet se:

- o Kur dokumentet përmbajnë material të klasifikuar, nga autoritetet publike kërkohet të publikojnë pjesët e pa klasifikuara të dokumentit, vetëm nëse publikimi i pjesshëm konsiderohet si çorientuese.

³ Administrata publike, faqe 11.

http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20141008_kosovo_progress_report_2014_sq.pdf

⁴ Qeverisja lokale, faqe 9

http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20141008_kosovo_progress_report_2014_sq.pdf

⁵ <http://www.sigmaweb.org/publications/Kosovo-Assessment-2014.pdf>

Megjithatë, ka nevojë për udhëzues lidhur me interpretimet e refuzimeve, pasi përmbajnë norma ligjore të pa definuar që japin shpjegime shumë të gjera. Ligji nuk është shumë i qartë se kush vendos për refuzim. Më e rëndësishmja, nuk ka autoritet qendror mbikëqyrës që mund të urdhëroj dhe të vejë sanksione tek institucionet për dështimin në sigurimin e qasjes në dokumente

Shumica e institucioneve publike nuk kanë krijuar mekanizma të brendshëm për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesave për qasje në dokumente publike.

- Probleme të theksuar ka pasur edhe me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit. Neni 10, thekson *se mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve tjera publike, gjykatës kompetente...megjithatë nuk definohet se cilat janë institucionet tjera publike.*

Në Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2013 poashtu theksohet ky problem. ⁶

- Ndonëse shumica e institucioneve publike kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, përgjegjësia për vendimmarrje nuk iu takon atyre, dhe shpesh ka paqartësi edhe në këtë drejtim.

⁶ http://www.ombudpersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_SHQIP_2013_396076.pdf

4 KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

4.1 Institucionet e përfshira në këtë Raport gjithëpërfshirës

Në këtë Raport janë të përfshirë të dhënat për rreth 160 institucione në të gjitha nivelet, të cilat kanë obligim që të zbatojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Fillimisht janë prezantuar të dhënat për tri institucione të nivelit qendror:

- Presidenca e Republikës së Kosovës
- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Më pas, janë prezantuar të dhënat për Qeverinë, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse, me gjithsej 79 institucione.

Sa i përket institucioneve të pushtetit lokal, janë prezantuar të dhënat për 38 komuna.

Nga institucionet tjera janë përfshirë raportet për pesë universitete publike, 17 ndërmarrje publike dhe 31 institucione të pavarura, të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha këto institucione, janë 7 institucione të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që nuk raportojnë, si dhe katër komuna të Republikës së Kosovës (shih 4.9)




Figura 1.

Institucionet e përfshira në Raportin Gjithëpërfshirës për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike

4.2 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

4.2.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ka pasur një përmirësim në mbajtjen e evidencave të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përveç kësaj, është rritur numri i institucioneve të cilat kanë caktuar zyrtar për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, dhe kanë dërguar raport tek Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit.

Tabelat e mëposhtme tregojnë pasqyrën e përgjithshme të kërkesave prej vitit 2011 e deri në vitin e kaluar, si dhe trajtimin që kanë marrë ato nga institucionet publike.

Tabela nr. 1:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2014 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	27	2	4	0	0	33
Qeveria, përfshirë ministritë dhe agjencitë vartëse	736	9	25	25	56	851
Institucionet e Pavarura	201	5	0	0	1	207
Universitetet	41	1	0	1	0	43
Ndërmarrjet Publike	15	1	0	0	0	16
Komunat	846	18	9	24	26	923
Totali	1866	36	38	50	83	2073

Tabela nr. 2:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2013 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	26	2	1	0	0	29
Qeveria, përfshirë ministritë dhe agjencitë vartëse	1095	11	26	34	7	1173
Institucionet e Pavarura	156	6	4	2	2	170
Ndërmarrjet Publike	59	0	0	0	0	59
Komunat	497	18	19	28	6	568
Totali	1833	37	50	64	15	1999

Tabela nr.3:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2012 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	45	1	/	/	/	47
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	540	52	8	/	15	615
Institucionet e Pavarura	79	4	1	/	2	86
Ndërmarrjet Publike	8	/	/	/	/	8
Komunat	530	36	8	/	14	588
	1202	93	17	/	31	1343

Tabela nr. 4:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2011 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	30	1	0	5	0	36
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	482	2	2	8	8	502
Institucionet e Pavarura	705	6	3	0	1	715
Komunat	1332	27	0	40	0	1399
Totali	2549	36	5	53	9	2652

4.2.2 Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit, numri i qasjes së lejuar në kërkesat për qasje në dokumente publike ka qenë dukshëm më i madh, se sa i kërkesave që janë refuzuar.

Megjithatë, shqetësuese është fakti që shumica e refuzimeve bëhen me heshtje administrative⁷, dhe nuk lëshohen me aktvendim⁸.

⁷ LQDP- Neni 10 -Mos përgjigja e Institucionit publik: "Refuzimi i kërkesës së kërkuarit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi".

⁸ LQDP- Neni 13 -Refuzimi i qasjes në dokumente zyrtare, pika dy: "Institucioni publik i cili refuzon qasjen në dokumentin në tërësi, apo pjesërisht, duhet të japë arsye mbi refuzimin. Kërkuari ka të drejtë, që pas parashtrimt të kërkesës, të marrë aktvendim të arsyetuar me shkrim, nga ai institucion publik, përkitazi me refuzimin"




Figura 2.

Realizimi i përgjithshëm i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës – krahasimi i viteve

4.2.3 Dërgimi i raporteve të institucioneve të Republikës së Kosovës

Në vitin 2014 është rritur numri i institucioneve të cilat kanë dërguar raportet e plota për kërkesat që janë parashtruar drejtpërdrejt në këto institucione.

Deri më tani, 85.00% për qind e institucioneve janë të përfshira në raportim.




Figura 3.

Dërgimi i raporteve tek Zyra për Komunikim Publik e ZKM-së, nga institucionet e Kosovës për kërkesat për qasje në dokumente publike

4.3 PRESIDENCA, KUVENDI I KOSOVËS DHE GJYKATA KUSHTETUESE

4.3.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese

Gjatë vitit 2014, në tri institucione, Presidencë, Kuvendi i Kosovës dhe në Gjykatë Kushtetuese, , ka pasur gjithsej 33 kërkesa për qasje në dokumente publike.

Tabela më poshtë pasqyron numrin e kërkesave të parashtruara në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës.

Tabela nr. 5:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Presidenca e Republikës së Kosovës	4	2	1	0	0	7
Kuvendi i Republikës së Kosovës	11		1	0	0	12
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	12		2	0	0	14
	27	2	4	0	0	33

4.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Tabela më pasqyron totalin e kërkesave të parashtruara në këto institucione.

Tabela nr 6:

Totali i kërkesave të shqyrtuara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
27	2	4	0	0	33

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Në figurën 3 janë paraqitur të dhënat që prezantojnë realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike në tri institucionet e mësipërme qendrore të Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha kërkesat e pranuar, 82 për qind të tyre iu është dhënë qasje e plotë, 12 për qind qasje e kufizuar, ndërsa janë refuzuar 6 për qind e kërkesave.

Realizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike




Figura 4.

Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike të këtyre tre institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës

- Arsyet kryesore të refuzimeve dhe qasjes së kufizuar

Vlen të theksohet se në asnjërin nga institucionet e mësipërme nuk ka pasur raste kur kërkesat për qasje në dokumente publike janë trajtuar me heshtje administrative, do të thotë pa iu dhënë asnjë përgjigje kërkesat.

66.67 % e refuzimeve janë bërë për të mbrojtur privatësinë dhe interesat tjera legjitime private, 16.67 për qind me arsyetimin e diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, ndërsa po aq, 16.67 % janë refuzuar në bazë të rregullit 23 të Rregullores për punën e Gjykatës Kushtetuese.




Figura 5.

Arsyet kryesore të refuzimit të kërkesave për qasje në dokumente publike tek Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese

- Dokumentet e kërkuara Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe në Gjykatë Kushtetuese

Ndër dokumentet më të kërkuara në institucionet qendrore gjatë vitit 2014 kanë qenë kopjet e kërkesave individuale, që përbëjnë 33.33 për qind të totalit të kërkesave.

Raporte të ndryshme janë kërkuar 15.15 për qind të kërkesave totale, po aq sa ka kërkesa edhe për letërkëmbime të ndryshme të nxjerra nga institucionet. 12.12 për qind e kërkesave janë bërë për të kërkuar të dhëna për kandidatët, ndërsa 9.09 për qind e tyre për dokumentet e tenderëve. Ndër të tjera, 6.06 për qind e kërkesave janë bërë për vendime të ndryshme të

institucioneve, ndërsa 3.03 për qind e kërkesave kanë qenë për projekte, po aq sa ka pasur kërkesa edhe për projekte dhe procesverbale.




Figura 6.

Lloji i dokumenteve të tre institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës në të cilat është kërkuar qasje

- Profili i aplikuesve

Kërkesat më të mëdha tek tre institucionet përkatëse publike gjatë vitit 2014 kanë ardhur nga gazetarët, të cilët përbëjnë 57.58 për qind të totalit të kërkesave.

Shoqëria civile ka bërë 18.18 për qind të kërkesave, ndërsa 12.12 për qind janë bërë nga individët. Operatorët ekonomikë kanë bërë 9.09 për qind të kërkesave totale, ndërsa 3.03 për qind nga organizatat buxhetore.




Figura 7.

Profili i palëve që kanë parashtruar kërkesa në institucione qendrore

- Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa

Nga të gjitha kërkesat e pranuar, në 97 për qind prej tyre, institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, i kanë dërguar përgjigjet në afat ligjor prej 7 ditësh.

Vetëm në 3 për qind të tyre, ka pasur kërkesë nga aplikuesit për rishqyrtim të vendimit të institucionit.



Figura 8.

Dërgimi i përgjigjeve nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës

- Mënyra e dhënies së përgjigjes në kërkesa për qasje në dokumente publike

Në 85 për qind, përgjigjet në kërkesat për qasje në dokumente publike nga ana e Presidencës, Kuvendit të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese janë bërë në mënyrë elektronike, ndërsa në vetëm 15 për qind të tyre janë dërguar kopje në letër.




Figura 9.

Mënyra e dhënies së përgjigjeve nga këto tri institucione qendrore

4.4 QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

Qeveria e Republikës së Kosovës, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë tjera vartëse, gjatë vitit 2014 kanë pranuar 851 kërkesa për qasje në dokumente publike.

Vlen të theksohet se agjencitë vartëse kanë pasur dyfish më shumë kërkesa se sa kërkesat e përgjithshme të ministrive.

Më së shumti kërkesa i janë adresuar Doganës së Kosovës, e pasuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Megjithatë ende mbetet i madh numri i agjencive të cilat nuk kanë pranuar kërkesa fare gjatë gjithë vitit.

Nga 58 institucione vartëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 49 prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë marrë asnjë kërkesë gjatë vitit 2014 për qasje në dokumente publike.

Sa i përket ministrive, më së shumti kërkesa ka marrë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me gjithsej 33 kërkesa, e pasuar nga Ministria e Shëndetësisë me 30 kërkesa. Ndërsa Ministria e Drejtësisë, e Punëve të Jashtme dhe e Administrimit të Pushtetit Lokal kanë pranuar vetëm nga 6 kërkesa, që është numri më i vogël i kërkesave i pranuar nga ministritë.

Më poshtë është tabela që pasqyron numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse.

Tabela nr.7:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

	Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
1	Zyra e Kryeministrit	13	2	1	3	0	19
2	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>	191	0	0	3	43	237
3	<i>Agjencia e Shtetërore e Arkivave të Kosovës</i>	0	0	0	0	1	1
4	<i>Agjencia për Barazi Gjinore</i>	0	0	0	0	0	0
5	<i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</i>	19	0	11	0	8	38
6	<i>Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore</i>	0	0	0	0	0	0
7	Ministria e Integritimit Evropian	8	0	0	0	0	8
8	Ministria për Komunitete dhe Kthim	3	0	2	3	0	8
9	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	7	0	1	0	2	10
10	<i>Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0

11	Agjencia Kadastrale e Kosovës	1	0	0	0	0	1
12	Ministria e Punëve të Brendshme	17	0	0	0	0	17
13	Policia e Kosovës	6	0	0	0	0	6
14	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	0	0	0	0	0	0
15	Agjencioni për Menaxhim Emergjent	0	0	0	0	0	0
16	Agjencioni për Regjistrim Civil	0	0	0	0	0	0
17	Inspektorati Policor i Kosovës	0	0	0	0	0	0
18	Agjencioni i Kosovës për Forenzikë	0	0	0	0	0	0
19	Ministria e Diasporës	7	1	1	0	0	9
20	Ministria e Administratës Publike	21	0	0	0	0	21
21	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	0	0	0	0	0	0
22	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	0	0	0	0	0	0
23	Ministria e Infrastrukturës	11	0	0	0	0	11
24	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	8	0	0	5	0	13
25	Instituti Pedagogjik	0	0	0	0	0	0
26	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	0	0	0	0	0	0
27	Qendra e Studentëve	0	0	0	0	0	0
28	Biblioteka Universitare	0	0	0	0	0	0
29	Agjencia e Kosovës për Akreditim	0	0	0	0	0	0
30	Agjencia për Aftësim Profesionak dhe për të Rritur e Kosovës	0	0	0	0	0	0
31	Instituti Albanologjik i Prishtinës	0	0	0	0	0	0
32	Inspektoriati i Arsimit në Republikën e Kosovës	0	0	0	0	0	0
33	Instituti i Historisë	0	0	0	0	0	0
34	Instituti i Leposaviqit	0	0	0	0	0	0
35	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	6	1	0	0	0	7
36	Agjencioni Pyjor i Kosovës	1	0	0	0	0	1
37	Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë	1	0	0	0	0	1

38	Ministria e Drejtësisë	5	1	0	0	0	6
39	<i>Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar</i>	0	0	0	0	0	0
40	<i>Shërbimi Korrektues i Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
41	Ministria e Financave	15	0	0	0	0	15
42	<i>Administrata Tatimore e Kosovës</i>	6	3	0	0	0	9
43	<i>Dogana e Kosovës</i>	284	0	0	0	0	284
44	<i>Agjencioni Qendror i Prokurimit</i>	0	0	0	0	0	0
45	<i>Njësia e Inteligjencës financiare</i>	0	0	0	0	0	0
46	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	7	0	0	0	0	7
47	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	18	0	3	0	0	21
48	<i>Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"</i>	0	0	0	0	0	0
49	<i>Teatri Kombëtar i Kosovës</i>	4	0	0	0	0	4
50	<i>Qendra Kinematografike e Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
51	<i>Galeria Kombëtare e Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
52	<i>Galeria e Ministrisë "Qafa"</i>						
53	<i>Ansambli Kombëtar Shtetëror i Këngëve dhe Valleve "SHOTA"</i>	0	0	0	0	0	0
54	<i>Filarmonia e Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
55	<i>Kosovafilmi</i>	0	0	0	0	0	0
56	<i>Baleti i Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
57	<i>Muzeu i Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
58	<i>Instituti Arkeologjik i Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
59	<i>Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve</i>	0	0	0	0	0	0
60	<i>Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore</i>	0	0	0	0	0	0
61	Ministria e Punëve të Jashtme	2	0	0	3	1	6
62	<i>Akademia diplomatike e Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
63	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	8	0	2	2	0	12
64	<i>Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës</i>	0	0	0	0	0	0
65	Ministria e Shëndetësisë	28	0	2	0	0	30

66	<i>Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
67	<i>Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale</i>	0	0	0	0	0	0
68	<i>Instituti i Kosovës për Shëndetësi Publike</i>	0	0	0	0	0	0
69	<i>Qendra Kombëtare për Transfuzion të Gjakut e Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
70	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	25	0	2	6	0	33
71	<i>Agjencia Kosovare e Standardizimit</i>	0	0	0	0	0	0
72	<i>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare</i>	0	0	0	0	0	0
73	<i>Agjencia e Promovimit të Investimeve e Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
74	<i>Drejtoria e Akreditimit të Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
75	<i>Agjencia e Metrologjisë së Kosovës</i>	0	0	0	0	0	0
76	<i>Agjencia për Pronësi Industriale</i>	0	0	0	0	0	0
77	<i>Inspektoriati i Tregut</i>	0	0	0	0	0	0
78	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	8	1	0	0	1	10
79	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6	0	0	0	0	6
		736	9	25	25	56	851

4.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Kosovës dhe në institucionet vartëse

Tabela e mëposhtme prezanton totalin e kërkesave për qasje në dokumente publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve vartëse duke përfshirë edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave.

Institucioni/ njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
ZKM dhe Ministrinë	223	6	14	22	4	269
Agjencitë e ZKM-së dhe të Ministrive	513	3	11	3	52	582
	736	9	25	25	56	851

Siç shihet në *Tabelën nr.8* kemi bërë ndarjen e këtyre institucioneve në dy grupe;

- **Grupi i parë:** Zyra e Kryeministrit dhe Ministrisë,
- **Grupi i dytë:** Agjencitë në përbërje të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Nga numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, në 86.49 për qind është lejuar qasja, është refuzuar në 1.06 për qind, ndërsa në 2.94 për qind është dhënë qasje e kufizuar.

Poashtu në 2.94 për qind të rasteve refuzimi është bërë duke mos u përgjigjur fare në kërkesat për qasje në dokumente publike, ndërsa në 6.58 për qind të kërkesave është kërkuar nga aplikuesi të jap më shumë sqarime lidhur me dokumentin që ka kërkuar, ose kërkesa e tyre është adresuar tek një institucion tjetër.

Më poshtë është grafiku që paraqet lejin e qasjes në dokumente të Qeverisë së Republikës së Kosovës të shprehur në përqindje.




Figura 10.

Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Kosovës

